



Restaurimi i Kishës së Shën Mërisë, Bishqethëm, Lushnje

20/1



MIRATOHET

PËR KKR

Sekretari i KKR

ARTA DOLLANI



RELACION PROJEKTI

Restaurimi i Kishës së Shën Mërisë

fshati Bishqethëm, Lushnje



Projektoi: Ark. Rudina Papavasili





Restaurimi i Kishës së Shën Mërisë, Bishqethëm, Lushnje



PËRMBAJTJA

1. VENDNDODHJA DHE PËRSHKRIMI HISTORIK	3
2. PËRSHKRIMI ARKITEKTONIK.....	4
3. ELEMENTËT ARKITEKTONIK.....	7
4. TEKNIKA E NDËRTIMIT	14
5. GJENDJA E KONSERVIMIT E KISHËS.....	14
6. NDËRHYRJET E PROPOZUARA	17





Restaurimi i Kishës së Shën Mërisë, Bishqethëm, Lushnje



VENDNDODHJA DHE PËRSHKRIMI HISTORIK

Myzeqeja në fundin e shekullit të XVIII-të dhe fillimet e shekullit të XIX-të, ishte shumë e rënduar nga masat shtypëse të politikës së bejlerëve dhe administratës turke. Ekonomia ishte e varfër, me toka djerrë e moçalore të përmytura nga vërshimet e lumenjve. Edhe konvertimi në fenë islame krijoi diferencime e lëvizje të popullatës, duke formuar zona e territore të braktisura e të varfra me një ekonomi feudale të prapambetur. Kështu emigrimi i popullsisë vllahe nga zonat juglindore gjeti terren dhe një mikpritje të ngrohtë nga banorët vendas.

Pikërisht në këtë periudhë tregtia mori hov në Myzeqe, ku bashkë me iniciativën sipërmarrëse, tregtarët voskopojarë sollën dhe kapitalet e tyre. Në fillimet e shekullit të XIX-të e në vazhdim, veç zhvillimit të tregtisë në qytetet myzeqare të Lushnjes dhe të Fierit, tregtia u shtri dhe në fshatrat e Myzeqesë me dyqane e tregti ambulante.

Bishqethmi, është një fshat i vogël, në rrethin e Lushnjes, që pozicionohet përgjatë rrugës nacionale Lushnje – Fier në anën lindore të saj, në ultësirën e Myzeqesë, ndërsa kisha e tij “Fjetja e Shën Mërisë” ndodhet rreth 1 km në jug të fshatit. Ajo është shpallur Monument Kulture i Kategorisë së Parë me Urdhër nr. 6, datë 15.01.1963 nga Rektorati i Universitetit të Tiranës. Monumenti ndodhet fare pranë autostradës Lushnje-Fier, rreth 1 km në jug-lindje të saj. Askesi për në Kishë është shumë i lehtë pasi rruga që të çon është në gjendje shumë të mirë.

Monumenti është ndërtuar në një terren të sheshtë, në një parcelë në formë drejtëkëndore të rrethuar dhe pozicionohet në qendër të saj. Në përfundim të parcelës është shtruar një rrugë që lidh rrugën lokale me kishën. Përreth kishës ndodhen varrezat e fshatit, të cilat janë të sistemuara. Pavarësisht terrenit të sheshtë dhe të lehtë për t'u mirëmbajtur, territori përreth ka pak pemë të larta dhe gjelbërim të ulët. Duke parë gjeometrinë e parcelës dhe mundësinë e saj, varrezat përreth mund të sistemohen duke krijuar rradhë të rregullta dhe do të ishte mirë nëse pjesa veriore e parcelës, e cila ndodhet pranë rrugës, të lihej e lirë dhe të trajtohej në trajtën e një kopshti hyrës. Po ashtu rreth e rrotull kishës, në një distancë prej 5 metrash të mos vendoseshin varre, duke i lënë hapsirë ndërtesës për drenazhim dhe mos ketë shtim dherash në të ardhmen.

Monumenti i përket periudhës pasbizantine, ndërtuar në vitin 1798 dhe pikturuar po në atë vit dhe është i tipit bazilikal, me konstruksion çatmaje dhe muraturë guri, i suvatuar dhe i mbuluar me tavan druri dhe çati me tjegulla. Përbëhet nga naosi, rrethohet me hajat në të tre drejtime: veri, përfundim dhe jug dhe ka një këmbanare në përfundim. Hyrja bëhet nga hajatit nga të treja anët. E njëjtë është edhe hyrja për në naos. Interieri i kishës është i veshur me piktura murale të pikturuara nga vëllezërit Çetiri.





Figura 1 Pamje e përgjithshme e kishës

1. PËRSHKRIMI ARKITEKTONIK

Forma planimetrike e kishës është naos trenefsh dhe një hajat i gjerë që e rrethon atë në tre anët. Ndarja e hajatit nga naosi duket qartë në fasadën lindore. Në perëndim, mbi çatinë e hajatit, ngrihet edhe këmbanarja, e ndërtuar me konstruksion druri. Mbulimi i të gjithë bazilikës, është me çati me konstruksion druri dhe mbulim me tjegulla. Dimensionet e jashtme të kishës janë 26.56 m x 17.45 m.

Naosi me plan drejtkëndor, ka dimensione të brendshme të përgjithshme 15.8 m x 7.1 m. Ai ndahet në tre nefe. Ndarja e tyre bëhet me rresht kollonash nga katër. Nefi qendror është lehtësisht më i gjerë dhe më i lartë se dy anësorët. Kolonat janë me seksion rrethor, përveç çiftit të kolonave më lindore të cilat kanë seksion katror.

Naosi ndahet nga ambienti i altarit nëpërmjet një ikonostasi druri.





Figura 2 Pamje e naosit

Mbulimi i naosit bëhet me tavan të rrafshët druri, i cili shkarkon në harqet prej çatmaje të ngritura mbi kolona dhe në muret perimetrale të naosit. Lartësia e brendshme e naosit, në pjesën e neft qendror nga dyshemeja deri në kulmin e kupolës së tavanin të drurit është 6.6 m, ndërsa ajo e neftve anësore nga dyshemeja deri në tavan është 5.2 m. Lidhja konstruktive në drejtimin gjatësor të kolonave bëhet me anë të qemerëve me konstruksion të lehtë çatmaje, të cilat përforëcohen me lidhje me tiranta druri, ndërsa në drejtimin tërthor ato lidhen me tiranta druri. Naosi ndriçohet nga katër dritare të pozicionuara në pjesën e sipërme të murit verior dhe jugor. Të gjithë muret e brendshme të naosit janë të pikturuara. Në anën perëndimore, kisha ka një mafil, me konstruksion druri, tek e cila ngjitesh me shkallë të pozicionuara në kolonën veri-perëndimore.

Hajati e rrethon naosin në të treja anët: veri, perëndim dhe jug, gjatë gjithë gjatësisë së brinjëve. Hapsira perëndimore është më e gjerë se dy hapsirat e tjera, për këtë arsye mbajtja e çatisë realizohet me kollona druri të vogla, me seksion drejtkëndor. Hajati trajtohet i mbyllur me muraturë guri dhe breza druri, dhe për ndriçimin e tij janë hapur dritare, dy në lindje, një në perëndim dhe katër në anën jugore. Mbulimi është realizuar me çati të pjerrët dy ujëse, ku pjesa më e ngritur e saj është në qendër të hapsirës perëndimore, pa tavan, me konstruksion me trarë druri dhe të mbuluar me tjegulla, si pjesa tjetër e çatisë. Çatia e tij është më e ulët nga çatia e naosit, duke nxjerrë në pah dritaret e murit të naosit. Hyrja për në hajat bëhet nëpërmjet 3 portave, një në secilin anë. Në murin



perëndimor, vihet re se muri përfundon më poshtë nga niveli ku fillon çatia, duke lënë të hapur këtë pjesë të objektit dhe duke nxjerr në pah konstruksionin e çatisë.




Figura 3 Pamje e hajatit (pjesa perëndimore)

Këmbanarja e pozicionuar në anën perëndimore, në qendër të hapësirës mbi hajat, është një konstruksion druri i hapur nga të gjitha anët dhe e mbuluar me çati katërujësë më tjegulla. Ajo ngrihet mbi çatinë e hajatit, me një seksion katërkëndor dhe mbahet në 3 kolona druri, me seksione të përafërta 20x20 cm. Në pjesën e sipërme të saj janë të hapura dritare (nga 1 për secilën faqe) të cilat janë mbuluar me rrjetë teli. Ngjitja për në këmbanare bëhet nga disa shkallë druri që mbështeten në konstruksionin e këmbanares. Dyshemeja e saj është e pashtuar. Aktualisht këmbanarja është jashtë funksioni.



Figura 4 Pamje e fasadë perëndimore dhe e këmbanares

2. ELEMENTËT ARKITEKTONIKË

ABSIDA

Bazilika, ka një ndërtim të thjeshtë dhe pa elementë dekorues. Zona me trajtim të veçantë është muratura e absidës nga jashtë. Absida është 7 faqëshe dhe trajtimi i saj është realizuar me 1 rradhë gurësh të bardhë të skuadruar dhe 3 rradhë tullash. Muratura kornizohet me 5 rradhë tullash ku rreshtat kanë dimensione që variojnë nga 7 - 9 cm, me një total prej 33 cm, të cilat janë vendosur në mënyrë të alternuar duke u vendosur një rradhë drejt dhe një rradhë në formë dhëmbë sharre. Rradha e parë dhëmbë sharre është me gurë të bardhë. Çdo rradhë del me shkallëzim, rreth 3 cm. Në qendër ndodhet një dritare e rrethuar me katër gurë të bardhë të skuadruar dhe mbrojtuar me zgarë metalike. Lidhja e materialeve është realizuar me llaç -gëlqere, me ngjyrë afërsisht në bezhë. Fugat janë trajtuar të holla tek rreshtat e gurëve (rreth 1 cm) dhe më të gjera në rreshtat me tulla (rreth 2-3 cm). Në të gjitha rastet fugat janë rrafsh me materialin ndërtimor dhe nuk e mbulojnë atë. Mbulimi i saj është realizuar si pjesa tjetër e kishës, me tjegulla, me një çati në formë gjysëm rrethore, me pjerrësi të ulët.



Restaurimi i Kishës së Shën Mërisë, Bishqethëm, Lushnje



Figura 5 Pamje e absidës

DYERT

Ambientet e hajatit dhe naosit kanë secili nga një portë nga çdo anë të faqeve të mureve.

Sot hyrja kryesore e kishës realizohet nga ana jugore, nëpërmjet hajatit e më pas nëpërmjet një dore në murin jugor të naosit. Këto dyer janë trajtuar me mbulim me qemerë, dhe nuk kanë elementë dekorativ. Dyert janë prej druri, me dy kanata me konfiguracion të thjeshtë. Konstruksioni është i realizuar me arkitra druri.






Restaurimi i Kishës së Shën Mërisë, Bishqethëm, Lushnje



Portë në fasadën perëndimore



Porta hyrëse në fasadën jugore. Kjo është hyrja kryesore e kishës sot



Portë nga ana veriore



Pamje e portës hyrëse (muri perëndimor i naosit)

Figura 6 Pamje e portave të kishës

DRITARET

Dritaret në të gjitha rastet janë drejtëkëndore me dimensione të vogla, me kasë druri të ndërtuara me arkitrarë druri. Në murin lindor të naosit, dy dritare, pozicionohen në çdo anë të absidës dhe janë të konturuara me kornizë guri dhe nga jashtë janë vendosur zgara hekuri.

DYSHEMEJA

Dyshemeja e naosit është e shtruar me pllaka çimentoje, me forma të rregullta kuadratiqe, ndërsa ajo e hajatit është e shtruar me pllaka qeramike.






Figura 7 Pamje e shtrimit në naos




Figura 8 Pamje e shtrimit në hajat (ana jugore)






TAVANI

E vetjma zonë e kishës e mbuluar me tavan është naosi. Tavani është trjtuar me ndarje kuadratike, ku në secilin kuadrat ngrihet një kupolë gjysëm sferike. Tavani është prej druri, me gdhëndje dhe i pikturuar.



Figura 9 Pamje e tavanit të drurit





MAFIL

Në anën perëndimore ngrihet një mafil me konstruksion druri, i cili sipas një shkrimi të gdhendur në të, është ndërtuar në vitin 1951 dhe pikturuar në vitin 1952. Konstruksioni i mafilit mbahet në kolona me seksione katrore prej druri.




Figura 10 Pamje e shënimit në mafil



Restaurimi i Kishës së Shën Mërisë, Bishqethëm, Lushnje



ELEMENTËT DEKORATIVË

Kisha është e mobiluar me karrike drurit në muret perimetrale, ambon e ikonostas.



Figura 11 Pamje të karrigeve në muret perimetrale





3. TEKNIKA E NDËRTIMIT

Kisha, i përket tipologjisë së kishave të zonës së Myzeqesë, të ndërtuara rreth shekullit 18-të, të cilat janë ndërtuar me muraturë guri për muret perimetralë, ndërsa kollonat e brendshme me konstruksion druri dhe konstruksion çatmaje.

Muret perimetralë janë të ndërtuar me gurë të lidhur me llaç gëlqere dhe të vendosur në mënyrë të çrregullt, të lidhur me breza druri dhe më pas të suvatuar nga jashtë e brenda. Trashësia e muraturës së naosit është 80 cm ndërsa muratura e hajatit është 60 cm.

Mbulimi i saj realizohet, me konstruksion druri dhe me çati me tjegulla. Naosi në brendësi ka mbulim me tavan të rrafshët, prej druri dhe të pikturuar, ndërsa hajati rreth tij, nuk ka tavan dhe evidentohet konstruksioni i çatisë.

Fasadat janë përgjithësisht të suvatuara, ndërsa fasada lindore është e pasuvatuar.

4. GJENDJA E KONSERVIMIT E KISHËS

Sipas dokumentacioneve dhe inspektimit në vend, ndërtesa nuk ka shfaqur probleme serioze në të kaluarën. Dokumentohet vetëm një ndërhyrje në këndin jug-perëndimor, me teknikë shqep-qep. Sot, monumenti paraqitet me disa problematika, të cilat janë karakteristike në këtë zonë.

- Fillimisht, evidentohet **lagështi kapilare** përreth gjithë hajatit të kishës, e cila vjen si pasojë e tokës së lagësht të zonës e cila evidentohet edhe në muret e brendshme të naosit. Kjo lagështi shfaq probleme duke filluar nga suvatimi, degradimi i lidhësit të muraturës, degradimin e brezave të drurit duke e rrezikuar muraturën e më tej të gjithë strukturën deri në shembje. Përgjithësisht kishat e zonës së Myzeqesë, kanë të gjitha këtë problem, duke qenë zonë me toka të lagështa. Në disa raste të ngjashme është bërë ndërhyrja me drenazhim perimetral, i cili propozohet edhe në kishën e Shën Mërisë së Bishqethmit.
- Evidentohet gjithashtu **lagështi që vjen nga çatia**, sidomos në pjesën e brendëshme të naosit, e cila duket qartë në pikturën murale të dëmtuar dhe pjesë të dëmtuar të tavanit të drurit. Për kontrollin e çatisë duhet të zbulohet fillimisht çatia nga tjegullat, dhe të inspektohet hollësisht gjendja e elementëve të drurit dhe gjendja e tjegullave, si dhe nëse ka shtresë hidroizolimi.
- Një ndër problemet kryesorë të ndërtesës, që po ashtu vjen nga lloji i tokës ku është ndërtuar, janë **uljet e objektit**.
- Në muret perëndimore të naosit dhe hajatit vihet re **humbja e mbushësit të brendshëm të muraturës**, duke shkëputur të dy paretet e murit dhe duke krijuar çarje (në rastin e murit të naosit) dhe inklinim dhe çarje në murin e hajatit. Ky fenomen vjen si pasojë e murit të naosit i cili ka një lartësi mjaft të madhe duke ushtruar shtypje. Duke mos patur lidhje të mirë vetë si muraturë dhe lidhje me murin perëndimor ai gjithashtu tenton të shtyjë këtë të fundit. Ndërhyrja në këtë rast është më e ndërlikuar, pasi të dyja paretet e murit të naosit janë me





pikturë murale. Kështu ndërhyrja, përveç se të plotësojë me mbushje dy paretet e muraturës dhe t'i konsolidojë ato, ajo duhet të konsistojë në krijimin e skemave lidhëse midis këtyre muraturave për forcimin e tyre.

- Një plasaritje e ngjashme vihet re në pikturën murale të murit lindor të brendshëm, e cila dokumentohet që në 1967, por nuk vihet re të ketë çarje në paretin e jashtëm të kësaj murature. Kjo plasaritje nuk evidentohet të ketë ndryshime nga dokumentimi.
- Konstruksioni delikat i **këmbanares**, duke qenë i gjithi drunjtë shfaq probleme në strukturat e këmbëve mbajtëse.
- Të gjithë elementët drusorë, konstruktiv dhe dekorues për shkak të insekteve dhe dëmtimeve të ndryshme, kanë nevojë për disinfektim, konsolidim dhe trajtimin e nevojshëm.
- Përveç problemeve strukturore të përshkruara më sipër, shfaqet problemi i **suvasë** që në të gjithë sipërfaqen e jashtme dhe të brendëshme, ka valëzime, plasaritje dhe mungesa.
- Rrezik paraqet po ashtu dekoracioni i tavanit, dekorimet e brendshme të kishës dhe piktura murale. Shkaku i këtyre dëmtimeve vjen si pasojë e mosmirëmbajtjes për një kohë të gjatë dhe lagështisë.

Gjendja e konservimit aktuale është si më poshtë:

1. NAOSI

- Kolonat në bazamentin e tyre janë të përforcuara me beton, i cili në shumë raste ka dëmtime, çarje dhe mungesa, ndërsa mbi shtresën e betonit ka dëmtime (mungesa, ekspozim të litarëve, degradim material lidhës, etj.) të çatmasë veshëse
- Ka një hapje nga sipër të të gjithë rreshtit të kolonave
- ABSIDA _ është në gjendje të mirë
- DYSHEMEJA ____ është në gjendje të mirë
- TAVANI I DRURIT_ Tavani ka krijuar bark, i cili fillon nga muri verior deri në atë jugor. Tavani është i pikturuar dhe ka nevojë për specialistët për hartimin e një projekti të plotë restaurimi. Gjithashtu është i rëndësishëm mbikëqyrja e tij, gjatë punime të çatisë
- PIKTURA MURALE, IKONOSTASI, KARRIKET_kanë nevojë për ndërhyrje, sidomos piktura murale, e cila ka dëmtime të mëdha nga lagështia

2. HAJATI

- Muratura e hajatit është e inklinuar, sidomos ajo në veri dhe në perëndim
- Ka mungesë të materialit lidhës
- Ka mungesë të suvaje





3. ÇATIA

- Në disa vende kanë marr bark trarët
- Tjegullat vendosen mbi petavra dhe nuk ka shtresë hidroizoluse. Kjo ka sjellë probleme shumë të mëdhaja lagështie.

4. DYERT DHE DRITARET

- Dyert janë në gjendje të mirë dhe relativisht të reja.
- Dera e naosit (në perëndim) ka çarje në qemer.
- Dera e hajatit (në perëndim) ka çarje në qemer.

5. STRUKTURA

- Muret e hajatit janë të inklinuar, me mungesë materiali lidhës, me lagështi kapilare dhe të palidhur në krye
- Në perëndim të muraturës së naosit evidentohet një çarje në mes të saj, në qemerin e derës dhe ngrihet lart vertikalisht.
- Brezat e drurit të muraturës duhen të rishikohen nëse kanë humbur aftësinë e tyre mbajtëse (shih rastin në anën lindore). Ato duhet të zvendësohen ose ritrajtohen. Aty ku mungojnë të plotësohen.

6. DRENAZHIMI DHE SISTEMIMI PËRRETH

- Nuk ka drenazhim dhe është i domosdoshëm.

7. SISTEMI I NDRIÇIMIT

- Përmirësimi i instalimeve elektrike dhe mungesë ndriçuesish

8. SHKAKU I DEGRADIMEVE

- Lagështi nga çatia
- Lagështi kapilare
- Degradim materiali lidhës
- Mosmirëmbajtja
- Mure të palidhur (hajati)
- Mure me lartësi të madhe
- Ulje të terrenit
- Ulje të trarëve të drurit





Restaurimi i Kishës së Shën Mërisë, Bishqethëm, Lushnje



5. NDËRHYRJET E PROPOZUARA

Ndërhryrjet e propozuara do të konsistojnë si më poshtë:

1. Realizimi i sondazheve për thellësinë e themeleve
2. Realizimi i një drenazhi perimetral
3. Restaurim çatie: tjegullat, shtresë katramaje, trarët e çatisë
4. Konsolidimi i kreut të murit të hajatit
5. Pajantime dhe shtyrje e murit verior
6. Injekttime dhe konsolidime muature në fasadë
7. Këmabanarja: konsolidim (petrifikim) i kollonave të drurit, restaurim i çatisë
8. Plotësim i shtrimit të dyshemesë së hajatit
9. Vendorsje breza druri aty ku mungojnë
10. Pastrim dhe fugatim murature
11. Suvatime të jashtme dhe të brendshme
12. Restaurim dhe F.V. dyer/ dritare/ shkallë
13. Trajtim i elementëve të drurit me vaj lini dhe antimol
14. Përmirësimi i sistemit elektrik dhe i ndriçimit
15. Heqja e depozitës në hajat
16. Projekt për pikturën murale
17. Projekt për tavanin e drurit / ikonostasin

